



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.05.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjt industrialë””

*(komision për dhënie mendimi)*

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare””

*(komision për dhënie mendimi)*

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Silva Caka

#### **Të ftuar:**

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Elvin Lako - Drejtor i Përgjithshëm

Rudina Bollano - Drejtore e Ekzaminimit

Përparim Mezini - Përgjegjës i Sektorit Juridik

Lindita Meneri - Përgjegjëse e Sektorit të Markave, Dizenjove Industriale dhe Treguesve  
Gjeografikë

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Të hyjnë mediet!

Mirëdita!

Meqenëse kuorumi për fillimin e mbledhjes është plotësuar, fillojmë nga puna.

Si pikë të parë e rendit të ditës, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjot industriale””. Relator është kolegu Edmond Leka. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Si pikë të dytë të rendit të ditës, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare””.

Relator është përsëri kolegu Edmond Leka. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: zonja Albana Shkurta, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë; zoti Elvin Lako, drejtor i Përgjithshëm; zonja Rudina Bollano, drejtore e Ekzaminimit, zoti Përparim Mezini, përgjegjës i Sektorit Juridik dhe zonja Lindita Meneri, përgjegjëse e Sektorit të Markave, Dizenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

I jap fjalën zëvendësministres për marrëveshjen e parë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjot industriale””.

Fjala është për ju, për të bërë një prezantim!

Më falni, një sekondë, sepse e ka kërkuar fjalën për procedurë zoti Alibeaj!

Më pas, e ka fjalën zoti Bylykbashi.

E kanë kërkuar fjalën disa kolegë të opozitës. Sot do të flisni të gjithë, sepse sot unë jam në një proces shumë të thellë reflektimi. Pas protestës së 26 majit dhe asaj pjesëmarrjeje masive, unë kam reflektuar shumë thellë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe i gjithë Grupi Parlamentar i PD-së po të dëshirojë të marrë fjalën, është i lirë ta bëjë.

Ju lutem, mbani qetësi dhe ta dëgjojmë njëri-tjetrin!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, e kam ndarë mendjen. Ju prita që dje, por ju nuk erdhët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për sa kohë të ketë mbledhje në këtë komision, jeni të lirë të vini të flisni që të gjithë me radhë deri në fund të qershorit, ashtu siç keni deklaruar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pa merak, se kam edhe mirëkuptimin e kolegëve këtu. Këta janë gati të heqin dorë edhe nga diskutimet e tyre për t'jua dhënë fjalën ju. Vetëm të dëgjojmë njëri-tjetrin!

Le të dëgjojmë kolegun Alibeaj!

**Enkelejd Alibeaj** - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt ajo që pritej sot pas protestës, për më shumë, para 30 ditëve nga data 28 qershor, kur do të mblidhet KE-ja, duhej të ishte një reflektim nga ju, zoti kryetar, por mbi të gjitha ky reflektim pritej nga disa të tjerë, të cilët jo si ju, nuk e kanë parë protestën e shqiptarëve si një moment nga i cili duhet të nxjerrin leksione të mëdha të moralit politik, si disa të tjerë, të cilët 30 ditë nga dita e mbledhjes së KE-së, kur do të vendoset një çështje e madhe për shqiptarët mbi të gjitha, e sigurisht, edhe për politikën, nuk japin as më të voglën shenjë reflektimi.

Sot, 30 ditë para datës kur do të mblidhet KE-ja, që do të japë vlerësimin, notën jo vetëm për klasën politike, por edhe për shqiptarët, për të gjithë historinë e tyre, për aspiratën e tyre për në Europë, unë besoj se duhet një thirrje e madhe për politikën dhe për publikun shqiptar. Publiku shqiptar, në fakt, foli. Shqiptarët folën në atë protestë dhe u ngritën ashtu të varfëruar, të terrorizuar, të frikësuar, në depresion social, në gjendje të keqe ekonomike, u ngritën për t'i dhënë një leksion të madh moral klasës politike. Ata u ngritën dhe treguan se kanë ende disa vlera morale, të cilat nuk i ndan kjo qeverisje. Ata nuk janë dakord me krimin, me drogën, me qeverisjen nga një qeveri, e cila të vetmen gjë që nuk e bën, është pikërisht të merakoset për ta.

Ata u ngritën për ta refuzuar këtë aliazh të frikshëm të qeverisë, krimit dhe drogës. Këto janë leksione të mëdha që me qetësi, siç e reflektuat edhe ju sot, do të duhet të lexohen, sepse rrugëtimi i Shqipërisë sonë për në Europë nuk është thjesht dhe vetëm një lojë e vogël tekash

midis maxhorancës së radhës dhe opozitës së radhës, por është mbi të gjitha një frymëzim, i cili buron nga shqiptarët. Tashmë barra për të folur është e politikës. Mbi të gjitha, është e kësaj maxhorance, marka e së cilës për të eksportuar për në Europë është siç duket krimi dhe droga, se në këta 5 vjet është treguar pikërisht kjo gjë.

Çfarë ka bërë kjo maxhorancë gjatë kësaj kohe? Sa e përkushtuar ka qenë kjo maxhorancë gjatë kësaj kohe? Sa e sigurtë ka qenë ajo për të kontribuar në çeljen e negociatave dhe për të marrë vlerësimin moral, që Europa do të duhet t'i japë vendit tonë?

Dy ministra të lidhur drejtpërdrejt me drogën. Një vend marka e të cilit është sot jeshile (ndoshta dhe e bardhë); një vend, që eksporton të vetmen gjë që Europa nuk e do, krimin dhe drogën; një vend, i cili sot, 30 ditë nga çelja eventuale e negociatave, nga mbledhja e KE-së, do të duhej të kishte dhënë prova të forta dhe energjike që e do çeljen e negociatave, ngrihet me një fakt edhe më të rëndë: ish-ministri i Brendshëm, i cili iu nënshtua me shumë presion hetimit penal, procedimit penal, pasi ju e mbrojtët në mënyrë fanatike, nuk ia hoqët imunitetin, derisa e dorëzuan në mënyrë të kontrolluar me një arrest shtëpiak, pas presionit të ndërkombëtarëve (nuk duhet të na mungojë sinqeriteti dhe duhet t'i tregojmë gjërat siç janë në këtë moment), sepse ju nuk donit, por për shkak të presionit të ndërkombëtarëve, u detyruat në mënyrë hipokrite t'ia nënshtonit procedimit penal dhe të vendosnit një masë të ndërmjetme pa i bërë dëm atij dhe me idenë për t'u hedhur hi syve ndërkombëtarëve me arrestin e tij shtëpiak.

Dje ndodhi më e paimagjinueshmja. Sistemi i drejtësisë, ai që duhej të ishte kali i betejës në luftën tonë të përbashkët për çeljen e negociatave, nuk bëri gjë tjetër, veçse atë që është provuar se është i zhytur në një veprimtari kriminale, se është anëtar i një grupi të strukturuar kriminal, anëtarët e të cilit janë të gjithë sot në burg, është i vetmi që ndodhet sot në Shqipëri, nën drejtësinë shqiptare dhe gëzon aromën e lirisë socialiste dhe rilindëse.

Kjo është marka me të cilën do të prezantohemi ne në 28 qershor? Ky është kontributi që do t'u japin ne europianëve, që ata të na pranojnë në gjirin e tyre?

Është edhe rasti tjetër i ministrit të Brendshëm aktual në detyrë, i cili është kapur në flagrancë duke mbrojtur një pjesëtar të familjes së tij, duke përdorur detyrën shtetërore, qoftë si kryetar i Komisionit të Ligjeve, sidomos tashmë, si ministër i Brendshëm, fsheh vendimin penal dhe bën gjithçka për ta mohuar e më pas detyrohet ta pranojë e më pas, për t'ia hequr drejtësisë të vëllain, siç e ka bërë zakon kjo qeveri dhe e degdis drejtpërdrejt në Itali për t'ia shmangur procedimit penal.

Kjo është marka me të cilën do të shkojmë në Europë, duke eksportuar atje edhe familjarët tanë të dënuar?

Kjo është ajo çfarë kërkojnë europeanët? Ky është kontributi ynë, apo është një sistem drejtësie totalisht të rrënuar dhe një Gjykatë Kushtetuese inekzistente?

Një pjesë të madhe të fajit (të themi të vërtetën), e ka edhe ky komision, me një sistem drejtësie nga Gjykata e Lartë, totalisht të paralizuar; me një sistem prokurorie të kapur nga Kryeministri e prokuror i Përgjithshëm, e me drejtues të Prokurorisë së Krimeve të Rënda; një drejtësi, e cila bën atë çfarë thotë publikisht Kryeministri.

Ky është kontributi që duhet të japim ne, si politikë?! Kjo është sintonia që duhet të kemi ne me publikun shqiptar?! Kjo është ajo çfarë na kërkohet nga europeanët?! Po, kemi barrë, kemi detyrim edhe ne të opozitës. E kemi sot, e kemi nesër dhe do ta kemi gjatë gjithë kohës detyrimin për të qenë në sintoni me shqiptarët, me ata që u ngritën, ata të cilët refuzuan qeverisjen!

E kishim ne detyrimin që të vazhdonim ta radikalizonim edhe qëndrimin tonë, edhe qasjen tonë, por, për hir të interesit publik, sot ndodhemi këtu në komision jo për t'ju bërë ftesë juve; e dini fare mirë që ftesave u keni mbyllur sytë dhe veshët, nuk doni t'ia dini aspak, por, së paku, nga ky tempull i shqiptarëve t'u flasim shqiptarëve.

Qëndrimi ynë është ky: ne, si opozitë, do të bëjmë maksimumin, siç e kemi bërë deri tani, jo duke heshtur, jo duke e fshehur të vërtetën, por duke e denoncuar atë fort, sepse kjo besojmë ne, madje edhe shqiptarët, është mënyra e vetme të na besojnë europeanët, ne të jemi të vërtetë dhe secili të marrë çmimin për atë çfarë ka bërë. Kjo është ajo çfarë ne kemi bërë si zgjedhje, që këtë periudhë, tik-taku, deri më 28 qershor, numërimi mbrapsht fillon sot. Por fillon për të gjithë shqiptarët, sigurisht; fillon për ne, dhe ne sot e kemi filluar, por, mbi të gjitha, sot dhe fillon për ju. Çfarë ju kushton juve? Çfarë i kushton kësaj maxhorance që, të paktën, për moral, për përgjegjshmëri politike, por edhe për detyrim ligjor, ministrin e Brendshëm aktual ta largojnë nga detyra?!

Largojeni nga detyra, mor, se nuk shkon që marka jonë e vetme, me të cilën ne do të shkojmë në Europë, të jetë një ministër i Brendshëm, vëllai i të cilit është i kapur në krim, ka shkuar më parë në Europë me pranga! Nuk shkon!

Por si mund t'i ofrohemi ne Europës me një ministër të Brendshëm, i cili ka kapur sistemin e drejtësisë?! Europeanët këtë kërkojnë nga ne: luftë ndaj krimit, luftë ndaj korrupsionit; një sistem drejtësie, i cili duhet ta ketë vendosur bandanën në sy, që të vendosë drejt e të peshojë

drejt për çdo shqiptar, ndërkohë që ministri i Brendshëm udhëheq sot jo vetëm krimin, jo vetëm policinë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, ta mbaroj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do ta mbyll, Bashkim, pa mërzitje!

Ta mbaroj!

Pra, sot marka që po i ofrojmë Europës është kjo.

A kemi ne mundësi, të gjithë bashkë, mor, por edhe juve, të rikuperojmë nga imazhi ynë, nga sinqeriteti që do të duhet t'i qasim Europës, duke larguar një ministër të Brendshëm? Kjo nuk është ndonjë gjëmë e madhe!

Pse, nuk ka mes jush njerëz që të mos kenë asnjë lloj lidhjeje?! Ka, sigurisht.

Pra, kjo është qasja që ne kemi ofruar.

Ftesa për shqiptarët është për të na gjykuar; për të na peshuar; për ta parë realitetin me sinqeritet. Madje është moment shumë i rëndësishëm, siç edhe ju e keni thënë, siç edhe Kryeministri i këtij vendi e ka thënë, që ky është një nga momentet më delikate të së ardhmes së këtij vendi, të së ardhmes europiane! Pas këtij momenti do të jetë shumë e vështirë, qoftë edhe për koston që po i krijoni ju, që ne të ofrohemi dhe të marrim çeljen e negociatave. Garë është, por, mbi të gjitha, është garë me moralin dhe lum ai që e fiton!

Kjo është thirrja që ne u bëjmë qytetarëve shqiptarë, që ju bëjmë juve, pjesës suaj, e cila pretendon të jetë e shëndoshë, që nuk ka lidhje me krimin, që nuk ka lidhje me drogën, madje që ka një dinjitet të vetin parlamentar dhe politik për të mbrojtur.

Sot jemi tridhjetë ditë para dhe këto tridhjetë ditë do të na keni këtu për t'ju u kujtuar juve dhe shqiptarëve deri ditën kur europianët të vlerësojnë nëse e meritojmë ose jo!

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Në fakt, numërimi ka filluar mbarë, sepse në datën 28 ne presim një vendim pozitiv nga Këshilli European. Kështu që, dashtë Zoti, për shqiptarët ky numërim ecën mbarë dhe jo mbrapsht, siç thotë opozita, dhe shqiptarët të marrin më në fund atë që kemi kërkuar prej 27 vjetësh!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjithsesi, do t'ju lutesha, për ekonomi kohe, sepse e kanë kërkuar fjalën për procedurë disa nga kolegët e opozitës, të respektojmë njëfarë minutazhi, që të flasim të gjithë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sipas radhës, fjalën e ka kolegu Bylykbashi, gjithnjë për procedurë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Oerd Bylykbashi** – Për procedurë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Absolutisht, me radhë.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, sa ishim ne...

**Ulsi Manja** – Patjetër, të gjithë. Anëtarë komisioni ose jo, kush ta kërkojë fjalën sot, do ta marrë gjithsecili.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Absolutisht, por vetëm të jemi racionalë te koha.

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti Manja, sa ishim tetë vjet në qeveri, integrimi europian nuk ishte “të shpresojmë te Zoti”, por të shpresojmë te puna që bëhet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Patjetër që me besimin në Zot, sepse e kemi edhe...

**Oerd Bylykbashi** – Ju po shpresuat vetëm te Zoti, ju bën...

**Ulsi Manja** – Edhe te puna, edhe te puna.

**Oerd Bylykbashi** – Më falni, ta vazhdoj unë, zoti Manja!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Me besimin te Zoti...

**Ulsi Manja** – Përsëri me fjalët e mia.

**Oerd Bylykbashi** – ...mund të shpresoni vetëm për kohën e mirë, për të rritur kanabisin përsëri, se për ndonjë gjë tjetër jo!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tani, keni sjellë këtu marrëveshjen “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare”. Jam i sigurt se gjëja e parë ku mund të kontribuoni, siç e tha edhe kolegu Alibeaj, është marka “grup i strukturuar mafioz”, këtë nuk jua heq njeri! Sikur edhe të



përpiqet njeri, këtë nuk jua kap dot. Madje mund t'ju ndihmojë ministria, t'jua sjellë si ta bëni aplikimin.

“Grup i strukturuar mafioz”. Të gjithë përpiqen të mbrojnë identitetet e tyre të prodhimit. Ajo që prodhoni ju është...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, kanabis, jo, ju prodhoni mafie. E keni eksportuar në Gjermani, e keni eksportuar në Holandë, në Itali, në Francë dhe në Spanjë. Pra, kudo ku kapet dhe zbërthehet një grup kriminal, që është me 500 kile drogë, heroinë apo kokainë, se kanabisin e kemi me tonelata, zbulohen 5, 10 ose 15 shqiptarë; këta jo nga emigracioni, por nga Shqipëria.

Vijnë informacione vazhdimisht për shqiptarë që vriten në vendet e Amerikës Latine; janë pikat e kontaktit të asaj mafies, që keni eksportuar ju!

Për shkak të kësaj marke tregtare “Grup i strukturuar mafioz”, që i keni dhënë ju Shqipërisë në botë, policitë e këtyre vendeve po krijojnë departamente të posaçme vetëm për krimin shqiptar, sepse është bërë gjithnjë e më agresiv. Madje Mbretëria e Bashkuar po tmerrohet nga eksporti i kësaj mafieje, i kësaj marke tregtare. Kështu që të sillni në komision gjëra të tilla është, në fakt, tallje për shqiptarët.

Tani, kam disa pyetje të thjeshta.

Besoj se ju kujtohet Fatmir Xhafaj kur fliste për reformën në drejtësi, kur erdhi këtu në krye të Komisionit për Reformën në Drejtësi. Ky, që sot jo thjesht ka vëllanë kryetrafikant droge, të dënuar për këtë, madje, më shumë se kaq, e ka mbajtur këtu, që të mos të vuajë, i ndryshon ligjin që ta shpëtojë nga vuajtja. Ky është ai i reformës në drejtësi?!

Besoj se ju kujtohet zoti Manja që Fatmir Xhafaj e quajti vëllain e tij njeri të mirë dhe se thjesht kishte qenë në kohën e gabuar, në vendin e gabuar me shokët e gabuar, a thua se kishin bërë sherr në bar. Në fakt, është trafikant droge, i dënuar!

Besoj se ju kujtohet zoti Xhafaj, që bllokoi ligjin “Për lojërat e fatit” vetëm e vetëm që të bënte pazarin me Kryeministrin Rama dhe të çonte përpara bizneset e vëllait të tij.

Besoj ju kujtohet zoti Xhafaj, që ishte i pari, pasi doli skandali i Saimir Tahirit që të nesërmen në mëngjes, pra ministri i Brendshëm, ish-kryetari i Komisionit të Ligjeve dhe ish-kryetari i Komisionit të Reformës në Drejtësi, mbrojti atë që ndërkombëtarët na e kërkojnë sot pas hekurave.

Tani, pyetja është shumë e thjeshtë: a nuk ka PS-ja përfaqësues të socialistëve të palidhur me krimin e organizuar, si rasti i Tahirit dhe i Xhafajt?! Nëse ikën Xhafaj, me kë tjetër, njësoj, do ta zëvendësoni?

Pyetja tjetër është: a nuk keni ju njeri që ju përfaqëson ju, socialistëve, që, në fund të fundit, mund të mos ta keni ngatërruar vetë në këto lloj pisllëqesh? Ua kam bërë këtë pyetje kolegëve socialistë këtu, në sy, në publik, në privat dhe shumë prej tyre skuqen, përtypen dhe thonë: “Po, kemi edhe të tjerë”. Por, në fakt, Edi Rama zgjedh këta. Ka një arsye, nuk është e thjeshtë, nuk është se kështu na e solli Zoti, siç erdhën retë sot, apo doli dielli!

Tani, lirimi i Saimir Tahirit, të nderuar kolegë, është prova shumë e qartë, pa asnjë lloj ekuivoku, i reformës në drejtësi që desh i Edi Rama dhe ia ekzekutoi Fatmir Xhafaj. Edi Rama desh një drejtësi që ta kapte ai. Qëllimin e kishte të thjeshtë: të mbrojtë vetveten nga të gjitha aferat e ndyra kriminale, jo thjesht korruptive, në të cilat është i zhytur qëkur ka qenë kryetar bashkie. Në këtë formë e mbajti për 10-11 vjet pushtetin në bashki, duke u shpërndarë leje ndërtimi kriminelëve në Tiranë dhe vazhdon sot e kësaj dite në dimensione shumë herë më të mëdha.

Zoti Manja, besoj se je turpëruar nga kolegët kriminelë, që ke pasur përkrah në legjislaturën e kaluar!

**Ulsi Manja** – Bashkë me ty i kemi pasur!

**Oerd Bylykbashi** – Edhe pse ishe...

**Ulsi Manja** – Bashkë kemi qenë.

**Oerd Bylykbashi** – ...shumë vokal kundër ligjit të dekriminalizimit në fillim dhe më pas u detyrova ta votoje!

Pra, Edi Rama donte këtë drejtësi dhe Fatmir Xhafaj ia ekzekutoi.

Rrugës, ky kryetar i Komisionit të Reformës në Drejtësi, sot ministër i Brendshëm, ndryshoi edhe ligjet për të mbrojtur kriminelët: mbron vëllanë e tij, mbron bandën e vëllait të tij, madje edhe të gjithë kriminelët e tjerë me atë rast. Tani, për ta mbyllur, zoti Manja, për sa kohë Edi Rama, si Kryeministër, do të fusë dorën në kotecin e trafikantëve për të zgjedhur ministra të Brendshëm, ministra të tjerë apo edhe deputetë, po aq herë ka për të kapur vezë llukë, siç thotë populli, që kur e çel, nuk del zog, por qelbet dynjaja!

Kështu që, bëni mirë, zoti Manja, të mos e pengoni integrimin e Shqipërisë me markën “Grup i strukturuar kriminal”, që është vetëm juaja. Kërkojini Fatmir Xhafajt të ikë ose largojeni ju! Të paktën i bëni nder vetes suaj, sepse shqiptarëve jua keni bërë qederin.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Në fakt, unë kam një ftesë për ju: mos e pengoni integrimin e Shqipërisë!

**Oerd Bylykbashi** – Ftesa është për Edi Ramën që të mos pengojë me krimin e organizuar integrimin e Shqipërisë.

**Ulsi Manja** – Si kryetar i komisionit, por edhe si koleg, ju ftoj të bëhemi bashkë për të ecur përpara dhe për të mos e penguar integrimin e Shqipërisë.

Fjalën për procedurë e ka Flamur Noka, anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare, por edhe mysafir në komisionin tonë. Për ekonomi kohe, edhe për ju vlen e njëjta thirrje, zoti Noka. Jeni ulur ngjitur me kolegun Fino si “bashkopozitarë”.

**Flamur Noka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Më vjen mirë që sot po përpiqesh të jesh gjeneroz për sa i përket dhënies së fjalës, por, me sa duket, e ke me qitje të largët këtë histori.

Ne po diskutojmë, por nuk e besoj se dikush prej anëtarëve të këtij komisioni apo edhe nga ata qytetarë që na ndjekin, ka ndonjëri mëdyshje për situatën në të cilën ndodhet vendi ynë.

Fakti që në të gjitha kancelaritë europiane ka pikëpyetje për vendimin përfundimtar për çeljen e negociatave, që do të jepet pas një muaji, tregon që këtu ka gjëra, të cilat ne duhet t'i shikojmë në sy dhe t'i korrigjojmë.

Opozita ka 5 vjet që u bie sirenave të këtij alarmi. Partia Demokratike, doni apo nuk doni ju, ka kontributin rrënjësor në procesin e rrugës europiane të Shqipërisë në 26 vjet. Kjo është një nga arsyet madhore që ne ndiejmë detyrim pak më shumë se ju që ky proces të përmbillet sa më shpejt. Nuk mund të thoni diçka ndryshe dhe nuk ka si të jetë ndryshe, sepse forca juaj politike, për fat të keq, deri tani nuk ka vënë asnjë tullë në themelet e rrugës apo të ndërtesës europiane të Shqipërisë. Rasti i parë që ju dha mundësia të ishit në pushtet dhe të kontribuonit për hapjen e negociatave të vendit është ky.

Nuk është e rastësishme që në fillimet e opozitës në vitin 2013 ne ngritëm alarmin që kanabizimi i Shqipërisë do të jetë një pengesë e madhe për rrugën europiane të Shqipërisë, por Kryeministri juaj dhe ju si maxhorancë vazhduat të mbyllnit herë njërin sy, herë të dy sytë,

pastaj filluat të mbyllnit veshët, madje dhe hundët, ndërkohë që në Shqipëri kundërmonte era e kanabisit.

Ju kemi paralajmëruar se kriminalizimi që po i bënit administratës dhe Kuvendit është i rrezikshëm dhe sigurisht që Shqipëria do ta paguajë një haraç për këtë gjë, por ju nuk donit t'ia dinit.

Kryeministri dilte në krah me ata që sot dekriminalizimi i ka flakur në vendin që u takon, në koshin e plehrave të historisë, duke i paraqitur si heronj, në rastin më të mirë, ndonjërin edhe si viktimë të shpifjeve të opozitës.

Sot, koha po tregon se kemi pasur të drejtë për këto fenomene, për të cilat kemi ngritur shqetësimet.

Nuk e kemi pasur hallin të karrigia jonë e pushtetit. E kemi pasur hallin të rruga europiane e Shqipërisë, sepse ju, me në krye timonierin dhe kryetëpsixhiun tuaj, po e futnit Shqipërinë në një qorrsokak. Dhe ja ku jemi sot.

Megjithëse jemi në opozitë, ne prapë jemi më të shqetësuar se ju për fatin e këtij vendi, që do të vendoset më 28 qershor.

Prandaj jemi të gjithë këtu, prandaj ishim në shesh, prandaj kemi zhvilluar protesta, për t'i bërë thirrje tëpsixhiut të reflektojë dhe të reagojë, sepse nuk ka të drejtë të marrë më qafë këtë vend, nuk ka të drejtë t'i japë rrokullimën integritetit të Shqipërisë, sepse është në atë karrige për t'i çelur rrugën vendit.

Kur ju kemi paralajmëruar se emërimi i Saimir Tahirit si ministër i Brendshëm, për shkak të CV-së së tij të kahershme, do të përbënte një rrezik për shtetin ligjor në Shqipëri, nga ana e Kryeministrit ironia nuk sosej.

Kur ju thamë se Shqipëria po kthehej në aerodromin e trafikantëve të drogës, ju vazhdonit ironinë në parlament dhe Kryeministrit, sigurisht, të gjithëve ju, avionët ju dukeshin mushkonja.

Kur ju thamë se korrupsioni galopant po ia merr frymën ekonomisë së këtij vendi dhe se po i detyronit shqiptarët të iknin nga Shqipëria, ashtu siç nuk i ka detyruar asnjë pushtues në histori, ju vazhduat t'ia mbyllnit sytë, ndërsa Kryeministri kishte vetëm një gjë: cinizëm, cinizëm dhe vetëm cinizëm, në sjellje, në fjalor, kundër opozitës. Përgjegjshmëri nuk kemi parë në asnjë moment.

Kur ju thamë se zgjedhjet duhet të jenë të lira, të ndershme dhe demokratike, nuk patët reflektim, përkundrazi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, kur të të vijë radha!

Nëse nuk të durohet, çohu dhe dil jashtë!

**Flamur Noka** – Ky është problemi, ju ka humbur edhe durimi. Kini durim!

**Ulsi Manja** – Zoti Noka, mund të vazhdoni. Përmbylleni mendimin.

**Flamur Noka** – Tërhiqi vëmendjen zotërisë!

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, të lutem, do të ta jap fjalën! Do të flasim të gjithë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flamur Noka** – Kur ju thamë se nuk mund të mbahet pushteti me paratë e drogës dhe me krimin e organizuar, ju mbyllët veshët. Kryeministri i ushqeui dhe i favorizoi vazhdimisht. Ja, ku jemi sot, për fatin e keq të shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Kryeministri dhe ju si maxhorancë jeni peng i mafies, jeni peng i krimit të organizuar dhe i bandave të drogës.

Nuk ka bërë ndonjëherë vaki që një opozitë të bëjë siç bëjmë ne, të shkojë kancelari më kancelari dhe në çdo takim me ndërkombëtarët të bëjë thirrje, më shumë se qeveria dhe maxhoranca, për të hapur negociatat. A e mbani mend pse them nuk ka bërë vaki? Sepse keni qenë ju në opozitë. Kur ishte çështja e rëndësishme dhe thelbësore për shqiptarët, liberalizimi i vizave, vutë çadrat para Kryeministrit, bëtë grevë urie, nuk latë gjë pa bërë. Griseldës i vutë një jastëk në bark, si të ishte shtatzënë, e çuat në Bruksel dhe supozuat që dështoi për shkak të bandës kriminale të Sali Berishës. Deri këtu shkoi fantazia antishqiptare juaja në kohën që ishit në opozitë. Ndërsa ne jo, sepse na dhimbset ky vend, na dhimbset edhe kontributi ynë për gjithë këta vjet në procesin e integritetit, ndaj jemi sot këtu, për t'ju thënë të reflektoni, sepse nuk mundet, nuk ua kanë borxh shqiptarët të kapërceni nga Saimiri i kanabisit të Fatmiri i kokainës. Kjo është e papranueshme për shqiptarët. Mos mendoni se keni maxhorancë absolute dhe nuk doni t'ia dini për qytetarët, për aksionin e opozitës apo për protestat e qytetarëve dhe se me 80 apo 76 vota që keni do të shkelni me këmbë shqiptarët dhe vullnetin e tyre.

Personalisht kam qenë dhe jam që me ju dhe me këtë maxhorancë të inkriminuar, të zhytur në drogë, të zhytur në korrupsion, ne duhet të ndërpresim çdo marrëdhënie. Megjithatë, unë jam deputet i opozitës dhe e respektoj vullnetin e saj. Ne jemi këtu për të kontribuar këto ditë dhe shpresojmë të hapen negociatat, por me arrogancën që shfaq Kryeministri prej 5 vjetësh, me

arrogancën që sillet maxhoranca, me zhytjen e vendit në batakun e krimit dhe të drogës, kam frikë se sinjalet janë dhënë. Megjithatë, jemi sërish për t'ju paralajmëruar: çdo gjë, çdo faturë do ta mbani në kurriz.

Më kot përpiqet Edi Rama të shantazhojë opozitën, më kot përpiqet të trillojë histori dhe barsoleta për të shmangur vëmendjen nga përgjegjësia. Përgjegjësia është një dhe vetëm një: Edi Rama dhe maxhoranca. Reflektoni sa nuk është vonë! Shqiptarët nuk ua kanë borxh t'u merrni peng të ardhmen e tyre për interesa të krimit të organizuar dhe të mafies.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Noka!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Një sekondë, zoti Fino!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord.

Duro, sepse edhe zoti Naço ka kërkuar fjalën. Do ta marrin me radhë, një këtej, një andej.

Në fakt, është e vërtetë, zoti Noka, ne ishim në opozitë kur ndodhi Gërdeci, por jua dhamë dorën juve si qeveri në atë kohë për ta futur Shqipërinë në NATO dhe e bëmë për hir të Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Sot nuk po e shikojmë gjëkund dorën tuaj për të çelur negociatat më 28 qershor, ndaj thirrja ime vazhdon për reflektim.

**Flamur Noka** – Dora jonë ka qenë ...

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Me këto veprime, po e shikoj.

**Flamur Noka** – Në çdo hap kontributi ynë ka qenë në këtë drejtim.

**Ulsi Manja** - Fjalën e ka zoti Fino për procedurë. Më pas zoti Mediu.

**Flamur Noka** – Mos bëj skizmat e Kryeministrit!

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Zoti Fino, për procedurë.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, duke pasur parasysh tolerancën tënde, por që e ka kaluar çdo lloj kufiri, dëgjova 3 kolegët e mi, sepse jam nga rreshti tyre, për procedurë dhe bën të njëjtën retorikë politike. Pra, thanë të njëjtat gjëra. Unë mendova se kishin gjëra të ndryshme, por jo.

Meqenëse ne jemi Komisioni i Ligjeve, kemi ardhur për punë, dëgjuam edhe kolegët e opozitës, të cilët ishin në të njëjtën linjë, siç na thanë këta, ne do të reflektojmë, por atë e kemi në

dorë ne si maxhorancë. Shumë mirë që kjo u bë edhe para medieve, në mënyrë që ta dëgjojë edhe qeveria, por a mund ta ndërpresim këtë retorikë politike për procedurë, sepse s'ka kuptim që edhe të tjerët të flasin të njëjtat gjëra dhe të vazhdojmë me projektligjet për të cilat jemi mbledhur? Kjo është procedura e vërtetë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

**Flamur Noka** – Më falni një sekondë!

Reflektim do të ishte që ju të mos bëheshit barrikadë për t'i mbrojtur imunitetin Saimir Tahirit dhe t'ia çonit Saimir Tahirin drejtësisë. Reflektim do të ishte kur Fatmir Xhafaj të jepte dorëheqjen, sepse moralisht nuk mund të qëndrojë në atë institucion. Ju me Saimir Tahirin të mbrojtur nga drejtësia, me drejtësinë të marrë peng nga Edi Rama, me Fatmir Xhafajn ministër, ju i keni vendosur një barrikadë integritit. Ju me këta tri hapa i keni bërë barrikadë të pathyeshme integritit.

**Ulsi Manja** - Fjalën e ka zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** - Zoti kryetar, sa për ta ditur...

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, janë edhe dy-tre kolegë nga opozita dhe mbaruan.

**Fatmir Mediu** – Për ata që nuk e dinë, por edhe për ata që nuk duan ta dinë, anëtarësimi dhe marrja e ftesës për anëtarësim të Shqipërisë në NATO nuk ka ardhur për shkak të tolerancës, por për shkak të reformave, duke respektuar atë që ishte bërë më parë, duke e vlerësuar atë dhe duke ndërtuar të gjitha rrugët e bashkëpunimit, sidomos në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke futur pas hekurave rreth 1200 banditë, nga qeveria jonë në atë kohë dhe duke bërë të gjitha reformat sipas kërkesave të ndërkombëtarëve dhe, për më tepër, duke dëgjuar ata që kishin skepticizëm në raport me Shqipërinë, që ngrinin pyetje dhe jo duke i anatemuar dhe duke i përgojuar siç bëni ju sot.

Të nderuar kolegë, çështja e integritit europian duhet të ishte një çështje që të na bashkonte në analizën tonë për situatën në Shqipëri dhe jo të na ndante në retorika politika.

Duke e dëgjuar me vëmendje njëri-tjetrin, por në radhë të parë zërin e qytetarëve shqiptarë, sepse qëllimi i tyre është integrimi europian, i cili i tejkalon kufijtë e Shqipërisë, është një qëllim dhe interes kombëtar, duke dëgjuar me vëmendje edhe autoritetet europiane, dua të kthej vëmendjen tuaj në qëndrimin e presidentit Makron, të presidentit Junker edhe në Parlamentin Europian, edhe në Samitin e Sofjes. Rajoni ynë ka një rrezik potencial, rrëshqitjen drejt raporteve, të cilat nuk kanë të bëjnë me Europën, drejt Lindjes, të influencave të Rusisë dhe

të Turqisë, fjalë për fjalë, apo rikthimet e konflikteve të vjetra në rajon. Pyetja shtrohet: ku jemi ne në këto raporte dhe në këto influenza? A jemi jashtë këtyre ndikimeve apo duhet të analizojmë realisht se çfarë po ndodh në vendin tonë? Këtë e ka thënë edhe Kryeministri, por ai po bën atë që nuk duhet ta bëjë, duke shkuar gjithnjë e më shumë drejt Lindjes. Ky është një shqetësim që ne duhet ta shikojmë me interesin më të madh.

Në qoftë se flasim për integrim europian, ajo që është thelbësore është dekriminalizimi, siç e nisëm me parlamentin, dekriminalizimi i qeverisë, dekriminalizimi i drejtësisë dhe i proceseve të rëndësishme të këtij vendi.

Unë nuk u heq asnjë prejse atyre që thanë kolegët e mi, por duhet ta shikojmë realitetin ashtu siç është, duke mos u nisur thjesht nga ajo që thotë opozita, por në atë çfarë pretendojnë ndërkombëtarët nga ne për ta realizuar si standard. Nuk mund të ketë Europë në Shqipëri pa një proces zgjedhor të lirë dhe të ndershëm. Nuk mund të ketë të ardhme europiane pa një të drejtë qytetare për të vendosur, dhe jo në blerje masive të votave, siç e ka përcaktuar në raportin e saj OSBE-ODIHR-i. Ky duhet të jetë një reflektim i përbashkët për të parë se si duhet që ne t'u japim pushtet qytetarëve dhe jo individëve të veçantë, siç ngrihet sot me shqetësim.

Po ashtu, kërkohet një qeverisje që të respektojë ligjin dhe rregullin dhe të respektojë qytetarin në radhë të parë. Kërkohet një qeveri kundër krimit dhe trafiqeve të drogës, në mënyrë që Shqipëria të mos njihet në institucionet europiane dhe në mediet europiane si Shqipëria e kanabisit apo e trafikut të drogës, kur në çdo moment media është e mbushur me problematika, edhe opinionet ndërkombëtare që vijnë për shkak të krimit në Shqipëri. Krimi në Shqipëri ka një burim të marrëdhënieve që ka krijuar me strukturat e shtetit dhe problemet që ka në mosluftimin e tij. Prandaj, është shumë e rëndësishme që ta shikojmë ashtu siç është realitetin në Shqipëri, të dëgjojmë me vëmendje skepticizmin e deputetëve të Bundestagut dhe të holandezëve dhe të mos i shajmë, sepse nuk na pëlqejnë, por t'i shikojmë si partnerë për të bashkëpunuar me ta, në mënyrë që të ecim përpara.

Ne kërkojmë një qeverisje, ku çdo qytetar të ketë të drejtën e tij për të ngritur zërin, për të protestuar dhe jo të masakrohet, siç u masakrua gazetari i Rilindjes Demokratike. Kjo është një situatë e turpshme që nuk duhet të ndodhë në Shqipëri.

Të nderuar kolegë deputetë, kërkohet një qeverisje kushtetuese, ku ka tre pushtete: pushteti parlamentar, i cili, pothuajse, nuk ekziston dhe është kthyer në një debat bosh, vetëm në mbështetje të interesave të qeverisë. Kërkohet një qeverisje e përgjegjshme, e cila respekton



detyrimet e saj kushtetuese dhe një pushtet gjyqësor. Ku jemi sot? Sot jemi nën qeverisjen e një individi të vetëm. Lexoni raportin e Dhomës së Lordëve të Parlamentit Britanik për shqetësimin që ngre për qeverisjen e drejtuar nga një individ në Ballkan. Ky është realiteti shqiptar dhe klaneve rreth e rrotull tij, që pa dyshim derivojnë në raporte me krimin e organizuar dhe situatën kriminale që kemi në Shqipëri, si me korrupsionin.

Shikoni çfarë po bëjmë me reformën në drejtësi, sepse jemi në komisionin përgjegjës për reformën në drejtësi. Ka shqetësime të ngritura jo vetëm nga opozita, por edhe nga specialistët. Kemi një situatë krejt të papranueshme të ngritur nga ekspertët, që i keni pasur ju në komisionin që ka përgatitur reformën në drejtësi, që po shkojmë drejt një pushteti gjyqësor inekzistent. Nuk do të ketë më gjyqtarë në Shqipëri, sepse keni menduar vetëm kë do të largoni dhe si do ta kontrolloni politikisht, por jo se kush do të jenë gjyqtarët në sistemin gjyqësor dhe sa të ndershëm dhe të përgjegjshëm duhet të jenë.

Sot kemi një Gjykatë Kushtetuese, e cila nuk ekziston më. Jemi i vetmi vend në Europë që ka një Gjykatë Kushtetuese që nuk ekziston; një Gjykatë Kushtetuese që duhet të mbrojtë dhe që është garanti i Kushtetutës; një Gjykatë Kushtetuese që mbron të drejtat e qytetarëve shqiptarë; një Gjykatë Kushtetuese, që jep u mundësinë qytetarëve shqiptarë, që atë të cilën nuk e bëjmë ne si ligjvënës ta bëjnë nëpërmjet referendumeve. Pra, kjo është situata që kemi sjellë nëpërmjet kësaj qeverisjeje.

Po ashtu, kemi një pushtet shumë të rëndësishëm, pjesa tjetër e pushtetit gjyqësor, që është Gjykata e Lartë, e cila është në kolaps total. Ne jemi krejtësisht të papërgjegjshëm dhe nuk merremi me këto gjëra, sepse pasojat i vuajnë qytetarët shqiptarë. Ky është standardi evropian: funksionimi i pushtetit gjyqësor për të dhënë drejtësi kur gabon edhe parlamenti, kur gabon edhe qeveria. Po ashtu kemi edhe një prokurori, e cila kontrollohet tërësisht nga politika, që, pa dyshim, shtyn në procese që përfundojnë në interesa politike, ku pasojat i vuan qytetari dhe ai që ka mundësi të ushtrojë presione dhe të kontrollojë procesin të jetë i lirë.

Këto nuk janë shqetësime që po i thotë opozita, por janë shqetësime të miqve tanë amerikanë, të Bashkimit Evropian, të OSBE-së, të EUROPOL-it e kështu me radhë, që deri dje ju i keni dëgjuar ose i keni interpretuar sipas qejfit tuaj. A do t'i marrim ndonjëherë në analizë seriozisht të gjithë bashkë dhe të themi që kemi apo jo nuk kemi përgjegjësi për të parë, si nga pikëpamja e legjislacionit dhe e kontrollit, që na e ka dhënë me të drejtë Kushtetuta, të kësaj qeverie? Çfarë jemi ne? Ne jemi një parlament që jemi kthyer vetëm në mbrojtës të qeverisë?!

Ne duhet të jemi parlamenti, që duhet të marrë në analizë çdo gjë, që ka të bëjë me qeverisjen, me respektimin e ligjit, në radhë të parë, me luftën e kundër krimit të organizuar dhe korrupsionin.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, është shumë e rëndësishme që ne të kuptojmë se ky moment që po kalojmë sot, para datës 28 qershor, duhet të na bashkojë në pretendimet që ngritën kolegët e mi. Nuk është çështje thjesht e një ministri, nuk është çështje thjesht e Kryeministrit, por është çështje e këtij vendi, e cila duhet të na preokupojë të gjithëve se si duhet të gjejmë rrugën e bashkëpunimit, në mënyrë që në datën 28 jo vetëm të hapen negociatat, por që ne të kemi shtruar të gjithë bazamentin e funksionimit të një shteti ligjor; të garantojmë zgjedhje të lira dhe të ndershme në Shqipëri; si dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor.

Prandaj, këto janë momente, të cilat kërkojnë nga gjithsecili nga ne mirëkuptim tjetër, jo vetëm për të mbajtur llogoret tona politike, por për të mbajtur atë që është interesi dhe llogorja politike e interesit tonë kombëtar dhe interesit tonë si shqiptarë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka kërkuar zoti Naço.

Ju lutem, jashtë këtyre emrave që janë depozituar këtu do të fillojmë me votimin e projektligjeve.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ju nuk merreni vesh me njëri-tjetrin dhe doni të merreni vesh me ne për integrimin.

Po, zoti Naço.

**Nasip Naço** – Faleminderit zoti kryetar, për qetësinë dhe durimin!

Siç duket mitingu i datës 26 maj ka reflektuar edhe te ju.

Unë nuk do t'u heq asnjë pikë dhe asnjë presje atyre që thanë kolegët e mi deputetë, por kam një pyetje për procedurë.

Sipas draftkalendarit të miratuar, ditën e djeshme duhet të vinte ministrja e Drejtësisë dhe të raportonte për prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2017. Të mërkurën e kaluar u kam thënë kolegëve të mi deputetë që të mos merreshin me ministrin dhe me prokurorin, sepse ditën e hënë do të vinte ministrja që të raportonte dhe do ta pyesnim drejtpërdrejtë. Pra, ne do ta pyesnim ministren e Drejtësisë për raportin e vitit 2017. Çuditërisht ditën e djeshme, besoj jo nga ju zoti kryetar, por nga sekretarja me kokë të saj, është hequr kjo pikë e rendit të ditës për të raportuar ministrja e Drejtësisë, sepse ajo ka pritur të jemi edhe ne të opozitës...

**Ulsi Manja** – Ja pra e thatë përgjigjen.

**Nasip Naço** – Sepse nuk do t'i shmanget pyetjeve që do t'i bëjmë 200 herë për Nazer Seitajn dhe për nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkesa ime për ju, zoti kryetar, por e bërë tashmë edhe medietike, është: kur do të vijë ministrja e Drejtësisë që të raportojë për prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2017? Ne kemi shumë dëshirë që ta pyesim për Nazer Seitajn, për ecurinë e hetimeve, si dhe për nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale.

Unë nuk besoj se ju do ta thërrisni pasdite, nuk besoj se do ta thërrisni në një datë kur të mos jetë prezent opozita, por besoj se edhe ju do të jeni të interesuar, edhe mediet, edhe opinioni publik, që të dimë më shumë lidhur me Nazer Seitajn.

Faleminderit, zoti kryetar, për vëmendjen dhe respektin që tregoni ndaj opozitës!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Naço!

Një shpjegim për kolegët e komisionit. Sigurisht që ishte në kalendarin e punimeve të këtij komisioni edhe raportimi i ministres së Drejtësisë. Në fakt, ne e kishim dje në rendin e ditës, por nuk ishit ju dhe ne nuk donim që ministrja e Drejtësisë të raportonte pa prezencën e opozitës. Kjo ishte arsyeja, shumë e thjeshtë.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti kryetar, edhe për komentin që bëtë!

**Ulsi Manja** – Në fakt, këtë e kërkova unë, si kryetar i komisionit, në mënyrë që të ishit edhe ju prezent kur të raportonte ministrja e Drejtësisë.

Ministrja është në dispozicion në çdo moment që do ta kërkojë Komisioni i Ligjeve.

**Nasip Naço** – Zoti kryetar, duke besuar në profesionalizmin tuaj, mendova se mbase e ka bërë sekretarja me kokë të saj.

**Nasip Naço** – Në fakt, e kam bërë unë, sepse kisha dëshirë që ju të ishit prezent kur të raportonte ministrja e Drejtësisë. Në fund të fundit, raportimi bëhet për punë 1-vjeçare të asaj ministrie, për të cilën, për hir të së vërtetës, i bie që të raportojë edhe për gjysmën e vitit që e keni drejtuar ju, si opozitë, atë ministri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, për 10 muaj.

Fjalën e ka kërkuar zoti Gurakuqi.

Zoti Gurakuqi do t'ju lutesha që të ishit shumë racional me kohën.

**Romeo Gurakuqi** – Do të respektoj procedurën.

**Ulsi Manja** – Në qoftë se do të flisni të gjithë me nga 10 minuta diskutim, atëherë i bie që këtu të jemi në seancë plenare. Në fakt, sipas Rregullores, jemi në punimet e Komisionit të Ligjeve. Pastaj ditën e enjte, mund ta merrni fjalën për 10 minuta apo 20 minuta, e kanë marrëveshjet. Pra, mund të flisni sa të doni në seancë. Kjo është shumë e thjeshtë, mos braktisni seancën, por flisni.

Urdhëroni!

**Romeo Gurakuqi** – Faleminderit, zoti kryetar!

E kërkova fjalën për procedurë dhe ka të bëjë me zhvillimet e ditëve të fundit. Në fakt, dje drejtësia juaj transitorë liron ish-administratorin e zonës së parë operacionale të trafikut të brendshëm, i kapur nga agjencitë ndërkombëtare ligjzbatuese në veprimtari ilegale.

Dua t'i bëj dy pyetje komisionit të nderuar: si shpjegohet që pushteti transitor i drejtësisë liron një politikan të kapur në veprimtari ilegale?

Së dyti, si shpjegohet që administratori aktual, i zonës së parë operacionale të trafikut të brendshëm, që njëkohësisht ka qenë edhe kryetar i Komisionit të Ligjeve për 5 vjet me radhë, nuk arriti të dorëzojë në organet ligjzbatuese shqiptare vëllanë e tij, por mori pjesë në ndërrimin e emrit dhe në ndërrimin e identitetit?

Në fakt, këtyre pyetjeve që unë ju bëra, shqiptarët u kanë dhënë një përgjigje krejt të qartë. Bëhet fjalë për një drejtim ekzekutiv, i cili kontrollon Ministrinë e Punëve të Brendshme, prokurorinë shqiptare dhe organet transitorë të drejtësisë dhe të gjithë së bashku janë vendosur në mbrojtjen, me çdo kusht, të aktorëve politikë, të kapur në veprimtarinë e rëndë ilegale, për llogari të kupolës, për shpëtimin me çdo mjet të pushtetit të fituar me aq shumë para, të garantuar nga policia dhe drejtësia që ju dëshironi.

Dua t'u kërkoj falje deputetëve të maxhorancës, të cilët nuk kanë asnjë lloj faji në këtë aferë që ka ndodhur, por dua t'u drejtohem atyre dhe gjithë opinionit publik shqiptar, duke u thënë se Partia Socialiste e Shqipërisë, me faktet që po ndodhin çdo ditë, është një parti e kapur nga një grupim i strukturuar kriminal që po plaçkit shtetin nën etiketën e reformimit dhe të integritimit europian. Në fakt, pyetjet që bëra sot, ia kam drejtuar që në shatorin e vitit 2015 kupolës ose atë që unë e kam quajtur direktorati i Partisë Socialiste në Komisionin e Ligjeve, të cilët krijuan këtë situatë transitorë. Domethënë, në muajin shtator të vitit 2015, kur u paraqit projekti i reformës në drejtësi, unë i kam bërë vërejtje publike komisionit tuaj të nderuar, zoti kryetar, dhe kam përcaktuar se ju keni ndërtuar një projekt, i cili, në pikëpamje të akteve

transitive para së gjithash, do të krijojë një vakuum institucional dhe një boshllëk; së dyti, do të vendosë gjyqësorin dhe prokurorinë në një kontroll të stërholluar nga maxhorancat politike. Por, gjithsesi, ju keni vazhduar me arrogancë duke iu përmbajtur linjës suaj dhe sot jemi në një situatë, të cilën e kam shpjeguar herën e kaluar, është një situatë e vakuimit institucional të pushtetit të drejtësisë, duke filluar nga drejtësia kushtetuese.

Vërejtjet nuk do t'i them me detaje, profesoreshës ia kam thënë. Gjithsesi, unë do të përqendrohem në 4 vërejtje kryesore:

Së pari, ndërhyrjet tuaja të pamenduara në pikëpamje të perspektivës, ju keni bërë një deformim total të republikës parlamentare, ndërkohë misioni i reformatorëve duhet të ishte efienca e sistemit të drejtësisë, dekriminalizimi i saj dhe organi i hetimit penal, pavarësi sa më të plotë nga politika, profesionalizmi, shmangia e konflikteve të interesit.

**Ulsi Manja** – Të lutem, zoti Gurakuqi, nuk dua t'ju ndërpres, por është e regjistruar audio e javës së kaluar, këtë diskutim e keni bërë javën e kaluar. Me gjithë respektin që kam, përmbylleni mendimin, sepse nuk jemi në seancë plenare.

**Romeo Gurakuqi** - Republika parlamentare, e ndërtuar nga ana juaj në mënyrë të pamenduar, praktikisht bëhet një kujtim i kohës së shkuar. Tani, ne priremi drejt një republike të drejtuar nga një monark, i zgjedhur me proporcional, një kryeministër ose një kryeparlamentar, që ndërton konsensusë klienteliste në Kuvend, varësisht domenit.

Së dyti, komisioni kishte kurorëzuar një projektkushtetutë të re, moderne të së ardhmes, që të zgjidhte të paktën tri nga problemet që janë evidentuar nga kriza pararendëse politike: pavarësia, përgjegjshmëria dhe efienca, por jo të ekspozonte një paçavure zhbilancuese, që do të minojë pavarësinë dhe do ta fusë vendin në një konflikt të mëtejshëm politik dhe konstitucional, sikurse rezulton sot. Këto i kam thënë 3 vjet më parë. Askush nuk do të dijë, pas këtij momenti, se cila është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe çfarë forme qeverisje keni krijuar ju.

Së treti, pavarësia personale e gjykatëseve profesionistë me këtë projekt dhe me këtë situatë që ju keni krijuar, nuk është e garantuar, ndërsa organizimi gjyqësor mendoj se është dhunuar nga njohja e të drejtave administrative të maxhorancës parlamentare mbi organet e drejtësisë dhe prokurorisë, sikurse ka rezultuar.

Së fundi, dua t'ju them se projekti dhe gjithë ndërhyrja juaj, e pamenduar dhe e pastrukturuar, e ka lënë sistemin brenda rrethit të ngushtë të klientelizmit, duke e lidhur më fort

me maxhorancën tuaj politike. Në qoftë se ju do të vazhdoni në këtë formë, me arrogancë të pakorrigjuar dhe të pandërhyrë, Shqipëria do të ketë një sistem neopatrimonial të drejtësisë dhe të qeverisjes, në të cilin institucionet ekzekutive do të kontrollojnë, sikurse kontrollojnë për arsye që i keni parë dhe dje, le të themi, burimet kyçe të patronazhit. Në fakt, është momenti të reflektohet për të bërë një axhustim politik, axhustim legjislativ dhe axhustim institucional. Pra, është momenti që deputetët e Partisë Socialiste të kryejnë dy ndërhyrje shumë të rëndësishme, sipas këndvështrimit tim, për të mirën e vendit dhe të integritetit europian në këto 30 ditë shumë të rëndësishme për Shqipërinë.

Së pari, duhet të bëjnë për veten e tyre, brenda vetes së tyre, një zgjidhje politike transitore, dhe të largojnë nga ekzekutivi drejtuesit ekzekutivë të kapur në trafik dhe në drejtimin e kupolës.

Së dyti, duhet t'i përgjigjen një zgjidhjeje politike për vendin, që do të përgatisë kushtet për një Shqipëri europiane në paqe, në ligj, në rend dhe në shërbimin publikut.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gurakuqi!

Ju lutem, nëse doni të flisni vetëm me medien, për respekt të kolegëve të mi, ne mund të dalim të gjithë, ta ndërpresim mbledhjen dhe ju komunikoni me medien. Tani, nëse doni t'ju respektojmë dhe t'ju dëgjojmë deri në fund, racionalitet kohe, ose ne po dalim, po ju them medieve të qëndrojnë këtu, dhe ju flisni.

**Romeo Gurakuqi** – Zoti Manja, unë isha shumë serioz. Ju lutem, merreni shumë seriozisht të gjithë fjalën time!

**Ulsi Manja** – Jo për thelbin e diskutimit, por për kohën. Nuk kam asgjë me thelbin e diskutimit tënd, sepse ti je i lirë të thuash mendimet e tua.

Urdhëroni, zoti Strazimiri!

**Gent Strazimiri** - Zoti Manja, shikoj se u thoni kolegëve: mos flisni gjatë, flisni pak më shkurt, sepse nuk kemi kohë, Rregullorja nuk jua njeh këtë të drejtë.

**Ulsi Manja** – Duhet të flisni për rendin e ditës.

**Gent Strazimiri** – Rregullorja nuk të njeh minutazh.

**Ulsi Manja** – Rregullorja nuk njeh as fjalë jashtë rendit të ditës.

**Gent Strazimiri** – Rregullorja nuk të njeh minutazh për këtë punë dhe fermi që ti lëshon në një moment të caktuar, duke e shitur, si *glasnost peristroika*, pra sikur je ti, ai që po i jep mundësi opozitës të flasë, jo Rregullorja...

**Ulsi Manja** – Patjetër, pse nuk ma dini për nder këtë. Ore, zotëri, keni seancën e ditës së enjte, që mund të flasësh sa të duash.

**Gent Strazimiri** - ... është jashtë kohe, është primitive, është tërësisht rurale dhe sovjetike.

**Ulsi Manja** – Unë e kam për nder që jam rural, zoti Strazimiri.

**Gent Strazimiri** – Dua të bëj një pyetje: pse nuk e doni integrimin?

**Ulsi Manja** – Ta dini, unë e kam për nder që jam fshatar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Gent Strazimiri** – Vasilika, dje ka ndodhur një gjë: ty, “si babai i reformës”, pra ‘jo nëna!, por babai i reformës, të ka rënë reforma në tokë. Të rroni vetë, se nuk jeton më reforma! Përpara gjyqit të Saimir Tahirit ka dalë ambasadori amerikan, Donald Lu (se nuk po ju dëgjoj të thoni se foli SHQUP-i), pra një nga miqtë më bujarë që keni pasur, ka thënë: “Ryshfet dhe presione ndaj trupit gjykues, që Saimir Tahiri të lirohet”. E ka rikonfirmuar përsëri, pasi u lirua Saimir Tahiri. Vetëm me këtë veprim ju kanë rënë dy pikat kryesore të asaj që kishit: “kemi çuar vendin me negociatë”. Çfarë ju kanë thënë? Reformat zgjedhore që ia keni vënë në kurriz breshkës dhe i keni thënë të lutem, ec pak shpejt se na duhet për negociatat, është reforma në drejtësi, që dje jua vrau Donald Lu, jo Sali Berisha, ju tregoi se çfarë keni bërë me atë, pra presion dhe ryshfet. Njëkohësisht, është edhe lufta kundër krimit të organizuar, Saimir Tahiri, që nuk ka bir nënë më, të thotë se nuk është i përfshirë, e tha profesori, me prova italiane, sot është jashtë, megjithëse ka paralajmëruar Donald Lu, shikoni me presion dhe ryshfet, ai do të dali jashtë.

Tani, më thoni pak: kur kishit vetëm dy gjeste për të bërë, të mos bënit presion dhe ryshfet për rastin e Saimir Tahirit, që të mos ju binte poshtë reforma në drejtësi; të mbanit në arrest shtëpie Saimir Tahirin, siç e kishit planifikuar më parë, domethënë, të mos shkonte dot në palestër, të mos shkonte dot në pishinë dhe kafën ta pijë në shtëpi, që të mos dilte poshtë te klubi. Të gjitha të tjerat i ka atje, kondicionerin, krevatin dhe gruan, pra të gjithë komoditetet i ka. Për kaq gjë keni lënë negociatat, sepse dje ju kanë rënë negociatat, reforma në drejtësi ju ka rënë, bashkë me Saimir Tahirin dhe lufta kundër korrupsionit. A ka mundësi të na shpejtoni, pse nuk i

doni negociatat more zotëri?! Kaq të thjeshtë e keni pasur 28 qershorin, ku mund të shkoni dhe të thoni: “Po, qeveria bëri reforma e të tjera”. A ka mundësi të na shpjegoni, pse nuk e doni hapjen e negociatave? Kaq kollaj e keni pasur. Ti këtë përgjigje nuk e jepni dot. Ti ke vendosur që sot këtu të shpallësh që me fermanin tënd ke bërë *glasnost peristroika*, Bashkimi Sovjetik i ’86-s, tërhiqni këmbën zvarrë, sepse si Bashkimi Sovjetik do të përfundoni, se atë po përpiqeni të rikrijoni. Po bëheni pjesë e një “Jurassic Park”. Nuk ekziston më! Edhe në qoftë se e keni parë te filmi i Spielberg, e kanë bërë në kompjuter, more, Ulsi! Nuk ekziston më.

**Ulsi Manja** – Pra, ti si qytetar do të dish...

**Gent Strazimiri** – E kanë bërë në kompjuter dhe në *software*. Në qoftë se doni t’ua shisni këtë shqiptarëve si film, atëherë përballuni me shqiptarët, se ne këtë detyrë kemi këtu.

Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Ju faleminderit, zoti Strazimiri!

Siç duket, perspektiva e negociatave është pozitive për shqiptarët dhe për Shqipërinë dhe opozita është bërë pishman për protestën e 26 majit, të dashur qytetarë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën e ka kërkuar nënkryetari i komisionit, zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Besoj se ky është një moment kaq i rëndësishëm....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Naço, e kam hequr kollaren, sepse kam parë deputetët e opozitës që janë pa kollare dhe nuk mund të mbaja vetëm unë kollare!

**Enkelejd Alibeaj** – Besoj se ky është një moment kaq i rëndësishëm, sa nuk meriton as edhe një lloj ironie, aq më tepër si kjo që po bëni ju, e cila nuk është aspak elegante, por kërkon një reflektim, siç premtuat në fillim të mbledhjes. Ju mund t’i tallni dhe t’i përqeshni të gjithë njerëzit që dolën dje dhe që i dhanë një leksion të mirë politikës. Në qoftë se nuk dini t’i lexoni leksionet, shpresa është e fundit, por është mirë t’i thërrisni mendjes, sepse ky është një moment i rëndësishëm politik, mbi të gjitha, për historinë e këtij vendi. Ne atë që kemi në dorë, jemi duke e ofruar. Merrini edhe ju përgjegjësitë tuaja historike! Kjo është ajo që kërkojmë ne sot; ajo që kërkon momenti; ajo që kërkon publiku, tek e fundit, ajo që kërkojnë europianët. Absolutisht që nuk kemi ardhur për të ndërprerë punën, por prioriteti numër 1 është plotësimi i kushteve për çeljen e negociatave. Largoni ministrin, sepse ai nuk meriton të jetë aty, sepse nuk na përfaqëson. Ne jo, publikun jo e jo, por as edhe ju. Ky është kontribut; ky është reflektim. Ne do



të vazhdojmë ta kërkojmë me ngulm gjatë gjithë këtyre 30 ditëve këtë gjë për të mirën e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me rendin e ditës.

Faleminderit! Të paktën të më thoshit faleminderit për mundësinë që ju dhashë, se e ktheva sallën e komisionit në tribunë të mendimit të lirë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ato që duhet t’i thoni në seancë, vini e i thoni këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Thuaj faleminderit, shoku qytetar!

Vazhdojmë me rendin e ditës. Ju kërkoj ndjesë përfaqësuesve të qeverisë! Zoti Naço, je i lirë të dalësh nga të duash, sepse deri tani bërë opozitën, tani dil nga krahu i maxhorancës.

Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjot industriale””.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Ju lutem, bëni shumë shkurt një prezantim për kolegët dhe prezantohuni!

**Elvin Lako** – Jam drejtor i Përgjithshëm...

**Ulsi Manja** – Besoj se na takonte ta bënim këtë sakrificë për fjalën e lirë të opozitës.

Ajo është bërë pishman për protestën e 26 majit dhe tani, siç duket, ka sinjale pozitive edhe për çeljen e negociatave dhe vjen në komision të mbulojë diellin me shoshë, sikur i plasi shpirti për negociatat. Edhe një herë, ju lutem, shkurt!

**Elvin Lako** – Faleminderit!

Dy traktatet, që janë paraqitur Komisionit të Ligjeve për dhënie mendimi, siç thatë edhe ju, zoti kryetar, janë dy traktate të WIPO-s, të cilat janë të parashikuara për t’u miratuar edhe nga Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale, e miratuar nga qeveria shqiptare për periudhën 2016-2020. Janë dy traktate që kanë të bëjnë me objektet e pronësisë intelektuale, konkretisht me përmirësimin e procedurave të klasifikimit dhe regjistrimit të dizenjove industriale dhe të markave tregtare. Të dyja traktatet kanë qëllim lehtësimin dhe unifikimin e procedurave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale. Me ratifikimin e këtyre traktateve Shqipëria do të ketë procedura më të thjeshta, më efikase dhe të unifikuara me të gjitha vendet anëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Fjalën e ka relatori, zoti Leka.

**Edmond Leka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i aderimit të Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos është krijimi i lehtësimit në kërkimet për klasifikimin e dizenjove industriale, shmangia e riklasifikimit të dizenjove, kur shkëmbehen dokumente në nivel ndërkombëtar, dhe përcaktimi i procedurave. Në aspektin ligjor dhe procedural ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Leka!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Pyetja e parë: a kemi pasur deri tani raste të regjistrimit të këtyre dizenjove nga kompani shqiptare?

E dyta, çfarë përfitojmë ne?

E treta, çfarë po bëni ju për të informuar kompanitë, zyrat dizenjuese dhe personat për t'u njohur me këto lehtësi dhe për të bërë regjistrimin e markave të dizenjove?

Faleminderit!

**Elvin Lako** – Të gjitha objektet e pronësisë industriale, ku objektet më të përdorura janë markat tregtare dhe të shërbimit (këtë vit ne festuam edhe 25-vjetorin e krijimit të zyrës), kanë 25 vjet që regjistrohen në Republikën e Shqipërisë. Këto vitet e fundit ka pësuar një rritje të ndjeshme të numrit të regjistrimeve. Për shembull, në të kaluarën kishte rreth 500-550-600 aplikime për marka në nivel kombëtar, kurse sot flasim për rreth 1200 aplikime të reja në vit për markat tregtare të shërbimit. Nëse u shtojmë këtyre edhe 3000 aplikimet që vijnë nga sistemi i Madridit, janë rreth 4000 aplikime të reja që i shtohen Republikës së Shqipërisë çdo vit. Të gjitha këto janë certifikata pronësie dhe janë pronë e atyre që i mbajnë këto. Këto traktate i shërbejnë lehtësimit të procedurave të regjistrimit, në mënyrë që të përdoren procedura të unifikuara të regjistrimit dhe të klasifikimit, në rastin konkret të dizenjove, siç i përdor e gjithë bota, sepse mbrojtja, siç e dini, ka karakter territorial, por edhe ndërkombëtar. Për të unifikuar të gjitha procedurat e mbrojtjes dhe klasifikimit të këtyre objekteve, shërbejnë këto traktate. Vetëm këtë vit kemi rreth 15 aplikime për dizenjo. Çdo vit janë rreth 20-30 aplikime. Ne kemi iniciuar shumë projekte, të cilat kanë si qëllim promovimin e mbrojtjes dhe rëndësinë që kanë ato për ata

që i posedojnë, qofshin individë apo biznese. Kjo ka dhënë rezultate, sepse ka një rritje, në disa raste edhe 300%, të aplikimeve për regjistrimin e këtyre objekteve.

**Ulsi Manja** – Faleminderit! A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjot industriale””. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Vazhdojmë me miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është pro miratimit në tërësi të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjot industriale””. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Raportin së bashku me sugjerimet e komisionit ia përcjellim komisionit përgjegjës për seancën plenare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

## **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 29.05.2018, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare” (*Komision për dhënie mendimi*)

### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

### **Mungojnë:**

Silva Caka

### **Të ftuar:**

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Elvin Lako – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Rudina Bollano – Drejtoreshë e Ekzaminimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Perparim Mezini – Përgjegjës i Sektorit Juridik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Lindita Meneri – Përgjegjëse e Sektorit të Markave, Dizenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit: projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare”. U lutem përfaqësuesve të qeverisë të bëjnë një prezantim të shkurtër për kolegët!

**Elvin Lako** – Edhe ky është një nga traktatet e WIPO-s dhe ka të bëjë me përmirësimin e kërimit që kemi ne, sidomos të pjesa ku flitet për markat tregtare të shërbimit. Në të kaluarën kërkitimi bëhej vetëm për fjalë. Siç e dini, markat përmbajnë edhe figura. Kjo ndihmon procesin e kërimit, në mënyrë që edhe markat që nuk kanë fjalë, por figurë të kërkohen dhe të dalin nga sistemi për ata që e kërkojnë apo për vetë procedurën e ekzaminimit që ndjek zyra, pra ka të bëjë me kërkitimin e elementeve figurative të markave tregtare.

**Ulsi Manja** – Faleminderit! Fjalën e ka relatori, zoti Leka.

**Edmond Leka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është aderimi i Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës.

Përparësitë që sjell aderimi në këtë marrëveshje janë: përdorimi i një klasifikimi të njëjtë në shumicën e vendeve të unionit të Parisit; lehtësimi i kërimit për markat tregtare e të shërbimit dhe shmangia e punës së konsiderueshme të riklasifikimit të tyre; krijimi i mundësive të njëjta të mbrojtjes dhe marrjes së informacionit të njëjtë me të gjitha vendet e unionit të Vjenës, të cilat konsistojnë në shumicën e vendeve të unionit të Parisit.

Jemi dakord për kalimin e këtij projektligji.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Leka!

A ka pyetje nga kolegët për marrëveshjen? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të marrëveshjes. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare””? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare””? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Këtë projektligj së bashku me raportin do t’ia paraqesim komisionit përgjegjës më pas do t’i përcillet seancës plenare për miratim. Me miratimin në tërësi të projektligjit, mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Faleminderit për durimin e treguar!

Pika e tretë e rendit të ditës, kërkesa e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, që ishte parashikuar për ditën e sotme, është shtyrë, sepse kryetari nuk ka qenë sot në Shqipëri dhe në diskutimin nën për nën është e domosdoshme pjesëmarrja e përfaqësuesve të Dhomës.

**Nasip Naço** – Për korrektesë, a mund të na kishit lajmëruar më parë që ishte ky problem?

**Ulsi Manja** – Po, qëndron vërejtja juaj, zoti Naço, pra duhej t’ju kishim njoftuar paraprakisht për heqjen e kësaj pike të rendit të ditës. Me sugjerimin e kolegut Naço për rendin e ditës e mbyllim mbledhjen e komisionit. Faleminderit për durimin! Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t’u njoftohen nga sekretaria e komisionit.

**Bashkim Fino** – Kjo që tha Naço ishte një budallëk i madh. Vërejtje duhet të bëhet kur shtohet ndonjë gjë në rendin e ditës, sepse thua që je i përgatitur, por për një gjë që është në rendin, për të cilën vjen i përgatitur, të të thuhet se shtyhet për efekt objektiv...

**Ulsi Manja** – Ka ardhur i përgatitur...

**Nasip Naço** – Lum ju që keni këtë gjë dhe shkoni nga fitorja në fitore...

**Ulsi Manja** – Zoti Naço kishte ardhur i përgatitur sot për pikën e tretë të rendit të ditës.

## **MBYLLET MBLEDHJA**

